



Npi – 01/120 datë: 28.03.2023

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 12 paragrafi 1 pika 5 të Rregullores Nr.17/2015 për Metodologjinë e Vlerësimit të Dëmeve nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera (FN&FT), Kuvendi i Komunës, pasi diskutoi për Raportin e Vlerësimit të dëmeve për muajt Janar-Tetor 2023, në seancën e mbajtur më 28.03.2024 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË VLERËSIMIT TË DËMEVE PËR PERIUdhËN JANAR-TETOR 2023

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e -III- të rregullt për vitin 2024, të mbajtur më 28.03.2024, me shumicën e votave miratoi Vendimin për vlerësimin e dëmeve të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera (FN&FT), për periudhën Janar-Tetor 2023, në shumën totale prej 50,658.09 euro.

II

A r s y e t i m: Kuvendi i Komunës, ka marrë parasysh edhe rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/108 të datës 26.03.2024, si dhe Raportin e Vlerësimit të dëmeve për periudhën Janar-Tetor 2023 të Komisionit Lokal për vlerësimin e dëmeve të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera Nr.08/01/36 të datës 23.10.2023.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi Kuvendit
Adnan Ademi